

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Menaxherial
(zgjidhjet)

P2

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE
All Questions Are Mandatory

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test.

Data 27.06.2026

CONTENT / PËRMBAJTJA

SESSION	MAXIMUM ASSIGNED	<u>-ATTENTION! THIS PART IS FOR SCAAK USE ONLY-</u> MARKS AWARDED
1. Problem 1	20	
2. Problem 2	20	
3. Problem 3	20	
4. Problem 4	20	
5. Problem 5	20	
Total	100	

Problemi 1

a) Të dhënat e mëposhtme i përkasin AGI Ltd për gjashtë muajt që përfundojnë më 31 dhjetor 2025.

Periudha	Prodhiimi (Njësi)	Kostoja totale (€)
Korrik	1,200	12,800
Gusht	900	11,200
Shtator	1,000	12,100
Tetor	800	10,800
Nëntor	1,400	13,700
Dhjetor	700	8,200

Kërkohet:

Duke përdorur analizën e regresionit

- i) Llogaritni koston variabile për njësi **(4 pikë)**
- ii) Llogaritni koston fikse për muaj **(2 pikë)**
- iii) Formuloni funksionin e koston totale **(2 pikë)**
- iv) Vlerësoni koston totale për prodhimin e 960 njësive **(2 pikë)**

b) Përgjigjuni pyetjeve në vijim:

i) Shpjegoni dallimin ndërmjet kostove fikse, kostove variabile dhe kostove të përziera. Jepni nga një shembull për secilën. **(4 pikë)**

ii) Çfarë është analiza e regresionit dhe për çfarë qëllimi përdoret në vlerësimin e kostove? **(3 pikë)**

iii) Përmendni dhe shpjegoni shkurtimisht dy kufizime të përdorimit të analizës së regresionit në parashikimin e kostove. **(3 pikë)**

(Gjithsej: 20 Pikë)

Problemi 1 - Zgjidhjet

a) Analiza e regresionit

i) Llogaritja e kostos variabile për njësi

X	Y	XY	X ²
1 200	12 800	15 360 000	1 440 000
900	11 200	10 080 000	810 000
1 000	12 100	12 100 000	1 000 000
800	10 800	8 640 000	640 000
1 400	13 700	19 180 000	1 960 000
700	8 200	5 740 000	490 000
Totali: 6 000	68 800	71 100 000	6 340 000

Koeficienti i kostos variabile (b):

b =	$[n\sum XY - \sum X \cdot \sum Y] / [n\sum X^2 - (\sum X)^2]$
	$[6 \times 71\,100\,000 - 6\,000 \times 68\,800] / [6 \times 6\,340\,000 - (6\,000)^2]$
	$[426\,600\,000 - 412\,800\,000] / [38\,040\,000 - 36\,000\,000]$
	$13\,800\,000 / 2\,040\,000$
	b = 6,7647 € për njësi (afërsisht 6,76)

ii) Llogaritja e kostos fikse mujore

a =	$\sum Y / n - b(\sum X / n)$
	$(68\,800 / 6) - 6,7647 \times (6\,000 / 6)$
	$11\,466,67 - 6\,764,71$
	a = 4 701,96 €

iii) Formulimi i funksionit të kostos totale

y =	mx + c
y =	6,7647x + 4 701,96

iv) Vlerësimi i kostos totale të prodhimit të 960 njësive

y =	$(6,7647 \times 960) + 4\,701,96$
	$6\,494,12 + 4\,701,96$
	y = 11 196,08 €

Shënim: Llogaritjet e ndërmjetme janë rrumbullakosur në dy shifra dhjetore. Koeficienti i saktë i regresionit është afërsisht 6,7647.

b)

i) Shpjegoni dallimin ndërmjet kostove fikse, kostove variabile dhe kostove të përziera. Jepni nga një shembull për secilën. (4 pikë)

Kostot fikse mbeten të pandryshuara në total brenda një periudhe dhe niveli përkatës të aktivitetit, pavarësisht ndryshimit të vëllimit të prodhimit. Shembull: qiraja mujore e fabrikës.

Kostot variabile ndryshojnë në total në përpjesëtim të drejtpërdrejtë me nivelin e aktivitetit, ndërsa kostoja variabile për njësi zakonisht mbetet konstante. Shembull: lënda e parë për çdo njësi të prodhuar.

Kostot e përziera përmbajnë një komponent fiks dhe një komponent variabil. Shembull: fatura e energjisë elektrike, e cila mund të ketë një tarifë bazë fikse dhe një pjesë që varet nga konsumi.

ii) Çfarë është analiza e regresionit dhe për çfarë qëllimi përdoret në vlerësimin e kostove? (3 pikë)

Analiza e regresionit është një metodë statistikore që mat dhe vlerëson marrëdhënien ndërmjet një variable të varur dhe një ose më shumë variableve të pavarura. Në vlerësimin e kostove, ajo përdoret për të përcaktuar se si ndryshon kostoja totale në raport me nivelin e aktivitetit, për të ndarë komponentin fiks nga ai variabil dhe për të formuluar funksionin e kostos, p.sh. $y = a + bx$. Ky funksion më pas shërben për parashikimin e kostove në nivele të ndryshme të aktivitetit.

iii) Përmendni dhe shpjegoni shkurtimisht dy kufizime të përdorimit të analizës së regresionit në parashikimin e kostove. (3 pikë)

1. Varësia nga të dhënat historike: rezultatet janë të besueshme vetëm nëse të dhënat e kaluara janë të sakta dhe përfaqësuese. Ndryshimet në çmime, teknologji, kapacitet ose kushte operative mund ta bëjnë modelin më pak të vlefshëm për të ardhmen.

2. Supozimi për formën e marrëdhënies dhe ndikimi i vlerave ekstreme: regresioni linear supozon një marrëdhënie afërsisht lineare ndërmjet kostos dhe aktivitetit. Nëse marrëdhënia është jolineare, ose nëse të dhënat përmbajnë vlera ekstreme, koeficientët dhe parashikimet mund të shtrembërohen.

Problemi 2

Gorm DAC prodhon një gamë lojrash me cilësi të lartë për të rritur dhe fëmijë. Kompania është e vendosur në Waterford dhe ushtron veprimtarinë e saj prej më shumë se njëzet vjetësh. Ajo prodhon tri lloje lojrash: lojra me 30 pjesë dhe me 250 pjesë për fëmijë, si dhe lojra me 1,000 pjesë për adoleshentë dhe të rritur.

Gjatë dy viteve të fundit, kompania ka përjetuar rritje të kërkesës për produktet e saj dhe ka zgjeruar prodhimin për ta përmbushur atë. Megjithatë, parashikimet e shitjeve për vitin aktual sugjerojnë se kërkesa për të gjitha llojet e pazëllëve është shumë më e lartë se në vitet e mëparshme.

Menaxheri i prodhimit ka bërë të ditur se kompania ka në dispozicion gjithsej 32,000 orë makinerie dhe 18,000 orë pune direkte për vitin aktual. Të dhënat e prodhimit dhe shitjes për tri llojet e lojrave paraqiten më poshtë.

	Loja me 30 pjesë	Loja me 250 pjesë	Loja me 1,000 pjesë
Materiale direkte:			
Karton @ €1.60 për metër	0.25 metra	0.5 metra	0.75 metra
Punë direkte @ €14.40 për orë	6 min	8 min	10 min
Kosto e përgjithshme variabile: 75% e kostos së punës direkte			
Orë makinerie të nevojshme	0.2 orë	0.25 orë	0.5 orë
Kërkesa e shitjeve për vitin (njësi)	50,000	27,000	36,600
Çmimi i shitjes për njësi	€3.60	€5.45	€7.85

Kostoja e përgjithshme fikse e buxhetuar e prodhimit vlerësohet në **€5,700 në muaj**, ndërsa kompania ka buxhetuar gjithashtu shpenzime të shitjes dhe administratës prej **€26,500 për vitin**.

KËRKOHET:

- (a) Bazuar në informacionin e dhënë më sipër, përcaktoni nëse Gorm DAC ka kapacitet të mjaftueshëm prodhues për ta përmbushur kërkesën e shitjeve për vitin e ardhshëm. Paraqitni llogaritjet që mbështesin përgjigjen tuaj. (4 pikë)
- (b) Llogaritni planin optimal të prodhimit për Gorm DAC për vitin aktual, duke paraqitur qartë fitimin e përgjithshëm të pritshëm. (13 pikë)
- (c) Shpjegoni kuptimin e termave të mëposhtëm: (3 pikë)
 - (i) Kosto relevante.
 - (ii) Kosto e zhytur (sunk cost).

(Gjithsej: 20 Pikë)

Problemi 2 – Zgjidhjet

(a) Kapaciteti i prodhimit për përmbushjen e kërkesës

	Kërkesa e shitjeve	Orët e punës direkte të nevojshme	Orët e makinerisë të nevojshme
Loja me 30 pjesë	50,000	5,000	10,000
Loja me 250 pjesë	27,000	3,600	6,750
Loja me 1,000 pjesë	36,600	6,100	18,300
		14,700	35,050
Orët gjithsej në dispozicion		18,000	32,000
Teprica/(mungesa) e orëve		3,300	(3,050)

Kompania nuk ka orë të mjaftueshme të makinerisë gjatë vitit aktual për të përmbushur kërkesën e shitjeve.

(b) Llogaritja e planit optimal të prodhimit dhe fitimit të përgjithshëm për vitin

Llogaritni kontributin për njësi të faktorit kufizues

Faktori kufizues = orët e makinerisë

	30 pjesë €	250 pjesë €	1,000 pjesë €
Çmimi i shitjes për njësi	3.60	5.45	7.85
Minus: kostot variabile për njësi			
Materialet direkte @ €1.60 për metër	0.40	0.80	1.20
Puna direkte @ €14.40 për orë	1.44	1.92	2.40
Kostoja e përgjithshme variabile: 75% e kostos së punës direkte	1.08	1.44	1.80
Kostot totale variabile për njësi	2.92	4.16	5.40
Kontributi për njësi	0.68	1.29	2.45
Orët e makinerisë për njësi	0.20	0.25	0.50
Kontributi për orë makinerie	3.40	5.16	4.90
Renditja	3	1	2

Plani optimal i prodhimit

Loja	Kontributi për njësi €	Prodhimi në njësi	Orët e makinerisë për njësi	Orët totale të makinerisë të nevojshme	Kontributi €
250 pjesë	1.29	27,000	0.25	6,750	34,830
1,000 pjesë	2.45	36,600	0.50	18,300	89,670
30 pjesë	0.68	34,750	0.20	6,950	23,630
Kontributi i përgjithshëm					148,130
Minus: kostot e përgjithshme fikse të prodhimit (€5,700 × 12 muaj)					68,400
Shpenzimet e shitjes dhe administratës					26,500
Fitimi					53,230

(c) Shpjegoni kuptimin e termave të mëposhtëm:

Kosto relevante

Kostoja relevante është një kosto që lidhet me një vendim të caktuar, sepse ndikon në alternativën që do të zgjidhet. Ajo është një kosto e ardhshme, inkrementale dhe që mund t'i atribuohet drejtpërdrejt vendimit.

Kosto e zhytur

Kostoja e zhytur lidhet me të kaluarën dhe nuk ndryshon nga vendimet aktuale apo të ardhshme. Prandaj, ajo nuk është relevante për vendimet aktuale dhe të ardhshme.

Problemi 3

Dubh DAC është e vendosur në Gjakovë dhe prodhon një produkt të vetëm: një njësi magazinimi të prodhuar nga plastika e ricikluar, e cila shitet me çmim prej €58 për njësi. Të dhënat e prodhimit dhe të shitjeve për secilin nga tre muajt e parë të vitit 2026 janë si më poshtë:

	Janar	Shkurt	Mars
Shitjet në njësi (reale)	4,800	5,000	7,600
Prodhimi në njësi (real)	5,400	4,800	8,000

Informacioni i buxhetuar i kostove për secilin muaj

Kostoja e produktit:

Materialet direkte: 2 metra katrorë me €4.20 për metër katror.

Puna direkte: 2 orë me €10.25 për orë.

Shpenzimet e përgjithshme variable të prodhimit: 50% e kostos së punës direkte.

Informacioni i kostove reale për secilin muaj

Shpenzimet e përgjithshme fikse të prodhimit: €12,000.

Shpenzimet e përgjithshme fikse të shitjes: €22,500.

Komisioni i shitjes: 10% e vlerës së shitjeve.

Më 1 janar 2026 nuk kishte inventar fillestar. Shpenzimet e përgjithshme fikse të prodhimit janë buxhetuar në €120,000 në vit dhe alokohen në koston e produkteve bazuar në prodhimin normal të buxhetuar prej 60,000 njësisish në vit.

KËRKOHET:

- Përgatitni pasqyrën e fitimit për secilin nga tre muajt, duke zbatuar parimet e metodës së kostos së absorbimit. (6 pikë)
- Përgatitni pasqyrën e fitimit për secilin nga tre muajt, duke zbatuar parimet e metodës së kostos variable (margjinale). (8 pikë)
- Paraqitni rakordimin e shifrave të fitimit ose humbjes të llogaritura në përgjigjet tuaja në (a) dhe (b), së bashku me një shpjegim të arsyes së diferencës. (3 pikë)
- Drejtori menaxhues i Dubh DAC dëshiron të përdorë parimet e metodës së kostos variable (margjinale) si bazë si për llogaritë e menaxhmentit, ashtu edhe për pasqyrat financiare të kompanisë. Paraqitni DY arsye kundër këtij veprimi. (3 pikë)

(Gjithsej: 20 Pikë)

Problemi 3 - Zgjidhjet

Llogaritjet ndihmëse

L1. Llogaritja e kostos së produktit

Sipas metodës së kostos së përthithjes/absorbimit

Përshkrimi	Shuma për njësi
Materialet direkte: $2 \text{ m}^2 \times \text{€}4,20 \text{ për m}^2$	€8,40
Puna direkte: $2 \text{ orë} \times \text{€}10,25 \text{ për orë}$	€20,50
Kostoja e përgjithshme variable e prodhimit: 50% e punës direkte	€10,25
Kostoja e përgjithshme fikse e prodhimit	€2,00
Kostoja totale e produktit për njësi	€41,15

Llogaritja e normës së përthithjes	Vlera
Kostoja e përgjithshme fikse e prodhimit për vitin (x)	€120.000
Kapaciteti normal i prodhimit për vitin në njësi (y)	60.000
Norma e përthithjes së kostove fikse për njësi (x/y)	€2,00

Sipas metodës së kostos variable (marginale)

Përshkrimi	Shuma për njësi
Materialet direkte	€8,40
Puna direkte	€20,50
Kostoja e përgjithshme variable e prodhimit	€10,25
Kostoja totale variable e produktit për njësi	€39,15

L2. Llogaritja e ndryshimeve në inventar/stoqe

Përshkrimi	Janar (njësi)	Shkurt (njësi)	Mars (njësi)
Inventari fillestar	0	600	400
Prodhimi	5.400	4.800	8.000
Gjithsej inventari i disponueshëm	5.400	5.400	8.400
Shitjet	4.800	5.000	7.600
Inventari përfundimtar	600	400	800

L3. Llogaritja e kostove të përgjithshme fikse të nën-/mbipërthithura

Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars
Kostoja e përgjithshme fikse aktuale e prodhimit	€12.000	€12.000	€12.000
Kostoja e përgjithshme fikse e përthithur	€10.800	€9.600	€16.000
Kostoja e nën-/ (mbi-)përthithur	€1.200	€2.400	(€4.000)

(a) Pasqyrat e fitimit sipas metodës së kostos së përthithjes/absorbuese

Dubh DAC – Janar, Shkurt dhe Mars (kostoja e produktit = €41,15; shih L1)

Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars
Shitjet	€278.400	€290.000	€440.800
Kostoja e shitjeve:			
Inventari fillestar	€0	€24.690	€16.460
+ Prodhimi	€222.210	€197.520	€329.200
– Inventari përfundimtar (shih L2)	(€24.690)	(€16.460)	(€32.920)
Kostoja e shitjeve	€197.520	€205.750	€312.740
Kostoja e nën-/ (mbi-)përthithur (shih L3)	€1.200	€2.400	(€4.000)
Fitimi bruto	€79.680	€81.850	€132.060
Komisioni variabil i shitjeve (10% e vlerës së shitjeve)	€27.840	€29.000	€44.080
Kostoja e përgjithshme fikse e shitjes	€22.500	€22.500	€22.500
Gjithsej shpenzimet e shitjes	€50.340	€51.500	€66.580
FITIMI	€29.340	€30.350	€65.480

(b) Pasqyrat e fitimit sipas metodës së kostos variabile (margjinale)

Dubh DAC – Janar, Shkurt dhe Mars (kostoja variabile e produktit = €39,15; shih L1)

Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars
Shitjet	€278.400	€290.000	€440.800
Kostoja variabile e shitjeve:			
Inventari fillestar	€0	€23.490	€15.660
+ Prodhimi	€211.410	€187.920	€313.200
- Inventari përfundimtar (shih L2)	(€23.490)	(€15.660)	(€31.320)
Kostoja variabile e prodhimit të njërive të shitura	€187.920	€195.750	€297.540
Komisioni i shitjeve (10% e vlerës së shitjeve)	€27.840	€29.000	€44.080
KONTRIBUTI	€62.640	€65.250	€99.180
Më pak: kostot fikse			
Kostoja e përgjithshme fikse e prodhimit	€12.000	€12.000	€12.000
Kostoja e përgjithshme fikse e shitjes	€22.500	€22.500	€22.500
Gjithsej kostot fikse	€34.500	€34.500	€34.500
FITIMI	€28.140	€30.750	€64.680

(c) Rakordimi i fitimit sipas kostos së përthithjes dhe kostos variabile/margjinale

Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars
Fitimi sipas kostos së përthithjes	€29.340	€30.350	€65.480
Rregullimi për kostot fikse të prodhimit në inventar:			
Janar: $(0 - 600) \times €2$	(€1.200)		
Shkurt: $(600 - 400) \times €2$		€400	
Mars: $(400 - 800) \times €2$			(€800)
Fitimi sipas kostos variabile	€28.140	€30.750	€64.680

Shpjegimi i diferencës

Diferenca ndërmjet fitimit sipas metodës së kostos së përthithjes dhe fitimit sipas metodës së kostos variabile (margjinale) lind nga trajtimi i kostove të përgjithshme fikse të prodhimit.

Sipas kostos variabile, të gjitha kostot e përgjithshme fikse të prodhimit njihen menjëherë si shpenzim i periudhës. Ndërsa, sipas kostos së përthithjes, një pjesë e këtyre kostove përfshihet në vlerën e inventarit të pashitur dhe bartet në periudhën e ardhshme kontabël. Kur inventari rritet, fitimi sipas kostos së përthithjes është më i lartë; kur inventari ulet, fitimi sipas kostos së përthithjes është më i ulët.

(d) Arsyet kundër përdorimit të kostos variabile (margjinale)

Drejtori menaxhues dëshiron ta përdorë këtë metodë si bazë si për llogaritë menaxheriale, ashtu edhe për pasqyrat financiare. Dy arsye kundër kësaj qasjeje janë:

- Kostoja variabile nuk është bazë e pranueshme për vlerësimin e inventarit/stoqeve në raportimin financiar, sepse bie ndesh me standardet kontabël (SNK), të cilat kërkojnë që inventari të përfshijë edhe një pjesë të kostove fikse të prodhimit.
- Mund ta shtyjë ndërmarrjen të pranojë kontrata ose porosi me çmime që nuk mbulojnë kostot fikse, duke shkaktuar humbje.
- Mund të krijojë vështirësi në vendosjen e çmimeve kur politika bazohet në “kosto plus marzh”. Marzhi duhet të jetë i mjaftueshëm për të mbuluar kostot fikse dhe për të siguruar fitimin, gjë që e bën procesin e çmim-vendosjes më të ndërlikuar.

Problemi 4

Beachy DAC ka zhvilluar një gamë të re sandalesh cilësore dhe me çmime të përballueshme për plazh. Sandalet bazohen në një dizajn inovativ që i mbron këmbët nga ndikimi i diellit, kripës dhe rërës. Kompania tashmë ka pranuar disa porosi për shitjen e sandaleve, ndërsa prodhimi pritet të fillojë muajin e ardhshëm. Kontabilisti menaxherial ka përgatitur parashikimet e mëposhtme për vitin e ardhshëm afarist:

(Prodhimi dhe shitja e 100,000 palë sandaleve)

	€	€
Shitjet		2,750,000
Kostoja e shitjeve:		
Materialet direkte	619,000	
Puna direkte (Shënimi 1)	411,000	
Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit (Shënimi 2)	236,000	1,266,000
Fitimi bruto		1,484,000
Shpenzimet administrative (Shënimi 2)	336,500	
Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes (Shënimi 2)	145,000	481,500
Fitimi		1,002,500

Shënime:

1. Supozohet se kompania do t'i paguajë punëtorët sipas sistemit të kohës fikse, pra sipas orëve të punuara, pavarësisht nga niveli i prodhimit të realizuar.
2. Shpenzimet e prodhimit, administrimit, shitjes dhe shpërndarjes janë analizuar sipas sjelljes së kostos, siç paraqitet më poshtë:

	Elementi fiks	Elementi variabil
Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit	25%	75%
Shpenzimet administrative	100%	nuk aplikohet
Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes	80%	20%

KËRKOHET:

- (a) Llogaritni pikën e rentabilitetit (break-even) në njësi (palë sandalesh) dhe në të ardhura. (5 pikë)
- (b) Llogaritni marzhin e sigurisë në njësi (palë sandalesh) dhe në të ardhura. (3 pikë)
- (c) Sa palë sandale duhet të shesë Beachy DAC për të realizuar një fitim prej €1,500,000? (3 pikë)

- (d) Beachy DAC po shqyrton ndryshimin e sistemit të pagesës së punëtorëve nga pagesa sipas kohës fikse në pagesë sipas njësisë së prodhuar (sipas copës). Sipas sistemit të ri, punonjësit do të paguhen €4.25 për çdo palë sandale të prodhuar. Nëse kompania e zbaton këtë sistem, do t'i duhet të punësojë një mbikëqyrës shtesë të prodhimit, i cili do të paguhet me pagë vjetore prej €60,000.

Duke supozuar se kompania e zbaton sistemin e ri të pagesës:

- (i) Cila është pika e re e rentabilitetit në njësi (palë sandalesh)? (4 pikë)
- (ii) Sa palë sandale duhet të shiten për të arritur nivelin aktual të fitimit, përkatësisht €1,002,500? (2 pikë)
- (iii) Cilin sistem të pagesës (sipas kohës fikse apo sipas copës) do t'ia rekomandonit kompanisë? Arsyetoni përgjigjen tuaj. (3 pikë)

(Total: 20 Pikë)

Problemi 4 – Zgjidhja

(a) Pika e rentabilitetit në njësi (palë sandalesh) dhe në të ardhura

Llogaritjet

Përshkrimi	Për njësi (€)	Gjithsej (€)
Shitjet	27.50	2,750,000
Kostot variabile		
Materialet direkte	6.19	619,000
Shpenzimet e përgjithshme variabile të prodhimit (75% e totalit)	1.77	177,000
Shpenzimet variabile të shitjes dhe shpërndarjes (20% e totalit)	0.29	29,000
Kostot totale variabile	8.25	825,000
Kontributi	19.25	1,925,000
Kostot fikse		
Puna direkte		411,000
Shpenzimet e përgjithshme fikse të prodhimit (25% e totalit)		59,000
Shpenzimet administrative		336,500
Shpenzimet fikse të shitjes dhe shpërndarjes (80% e totalit)		116,000
Kostot totale fikse		922,500
Fitimi		1,002,500

Pika e rentabilitetit në njësi

Formula: Kostot totale fikse ÷ Kontributi për njësi

$€922,500 \div €19.25 = 47,922$ palë sandale (afërsisht)

Pika e rentabilitetit në të ardhura

Formula: Kostot totale fikse ÷ Raporti i kontributit ndaj shitjeve

Raporti i kontributit ndaj shitjeve = $€19.25 \div €27.50 = 0.70$

$€922,500 \div 0.70 = €1,317,857$

Kontroll alternativ: $47,922 \text{ palë} \times €27.50 = €1,317,855$

(b) Marzhi i sigurisë në njësi (palë sandalesh) dhe në të ardhura

Duke supozuar se shitjet aktuale janë të barabarta me shitjet e parashikuara:

Marzhi i sigurisë = Shitjet e pritshme – Shitjet në pikën e rentabilitetit

Në njësi: $100,000 - 47,922 = 52,078$ palë sandale

Në të ardhura: $€2,750,000 - €1,317,857 = €1,432,143$

(c) Numri i palëve të sandaleve që duhet të shiten për të realizuar fitim prej €1,500,000

Njësitë për fitimin e synuar = (Kostot totale fikse + Fitimi i synuar) ÷ Kontributi për njësi

(€922,500 + €1,500,000) ÷ €19.25 = 125,844 palë sandale (afërsisht)

Kontrolli i llogaritjes (nuk kërkohet nga pyetja)

Përshkrimi	€
Të ardhurat totale nga shitjet: 125,844 palë × €27.50	3,460,710.00
Minus: kostot totale variabile: 125,844 palë × €8.25	1,038,213.00
Kontributi total	2,422,497.00
Minus: kostot totale fikse	922,500.00
Fitimi (afërsisht €1,500,000)	1,499,997.00

Shënim: Meqenëse produkti shitet në njësi të plota, në praktikë numri i kërkuar duhet të rrumbullakoset lart kur rezultati nuk është numër i plotë.

(d) Ndryshimi i bazës së pagesës së stafit

Llogaritjet e rishikuara – për njësi

Përshkrimi	Për njësi (€)
Çmimi i shitjes për një palë sandale	27.50
Kostot variabile të rishikuara	
Materialet direkte	6.19
Puna direkte sipas njësisë së prodhuar	4.25
Shpenzimet e përgjithshme variabile të prodhimit (75% e totalit)	1.77
Shpenzimet variabile të shitjes dhe shpërndarjes (20% e totalit)	0.29
Kostot totale variabile	12.50
Kontributi i rishikuar	15.00

Kostot fikse të rishikuara

Përshkrimi	Gjithsej (€)
Shpenzimet e përgjithshme fikse të prodhimit (25% e totalit)	59,000
Paga e mbikëqyrësit shtesë	60,000
Shpenzimet administrative	336,500
Shpenzimet fikse të shitjes dhe shpërndarjes (80% e totalit)	116,000
Kostot totale fikse të rishikuara	571,500

(i) Pika e re e rentabilitetit në njësi

Formula: Kostot totale fikse ÷ Kontributi për njësi

€571,500 ÷ €15.00 = 38,100 palë sandale

(ii) Numri i palëve që duhet të shiten për të arritur nivelin aktual të fitimit

Fitimi i synuar = fitimi aktual i pritshëm prej €1,002,500.

Njësitë për fitimin e synuar = (Kostot totale fikse + Fitimi i synuar) ÷ Kontributi për njësi

$(€571,500 + €1,002,500) \div €15.00 = 104,933$ palë sandale (afërsisht)

(iii) Rekomandimi lidhur me sistemin e pagesës

Rekomandim: Vendimi duhet të mbështetet në objektivat e kompanisë, kontrollin e cilësisë dhe sjelljen e punonjësve. Në përgjigje duhet të paraqiten së paku dy arsye të arsyetuara.

Arsyet në favor të pagesës sipas copës	Arsyet në favor të pagesës sipas kohës fikse
• Kostot fikse janë më të ulëta, prandaj zvogëlohet presioni mbi kompaninë për të realizuar fitim. • Pika e rentabilitetit në njësi është më e ulët; kompania duhet të shesë më pak njësi për të mbuluar kostot. • Punonjësit mund të motivohen të prodhojnë më shumë njësi për të rritur pagën e tyre. • Mund të pranohet edhe çdo argument tjetër relevant dhe i arsyetuar.	• Për të arritur nivelin aktual të fitimit nevojiten më pak njësi: 100,000 palë, krahasuar me rreth 104,933 palë sipas pagesës për copë. • Punonjësit mund të ndihen më të sigurt dhe më të motivuar, sepse marrin pagë fikse. • Cilësia e produktit mund të jetë më e mirë; rrjedhimisht kostot e kontrollit dhe inspektimit të cilësisë mund të jenë më të ulëta. • Mund të pranohet edhe çdo argument tjetër relevant dhe i arsyetuar.

Pagesa sipas copës ul pikën e rentabilitetit, por mund të krijojë presion mbi cilësinë dhe kërkon shitjen e më shumë njësi për të arritur fitimin aktual. Prandaj, kompania duhet të peshojë kursimin e kostove kundrejt ndikimit në cilësi dhe motivimin e punonjësve.

Problemi 5

Të dhënat në vijim të kompanisë ABC i përkasin prodhimit të 2,000 copë vazo nga deltina gjatë Korrikut.

Materialët direkte (të gjitha materialet e blera janë shfrytëzuar):

Çmimi standarde:	€6.00 për kg të vazës.
Gjithsej çmimi aktuale:	€11,200.
Çmimi standard i lejuar për njësitë e prodhuara ishte	€12,000.
Varianca e efikasitetit të materialeve ishte	€240 e pafavorshme (PFV).

Puna direkte:

Çmimi standard është 2 vazo për orë	€24.00 për orë.
Çmimi aktual për orë ishte	€24.50.
Varianca e efikasitetit e punës ishte	€672 favorshme (FAV).

KËRKOHET:

- Sa është sasia standarde e materialit për prodhimin e një vazoje? (4 pikë)
- Sa është varianca e çmimit të materialeve direkte (MD)? (6 pikë)
- Sa është gjithsej çmimi aktual për punën direkte (PD)? (6 pikë)
- Sa është varianca e çmimit për punën direkte? (4 pikë)

(Total: 20 Pikë)

Problemi 5 - Zgjidhja

a. Kosto standarde per vaso = €12,000/2,000 = €6.00 per vaso

KG standard per vaso = €6.00/€6.00 = 1.0 kg per vaso

b. $\text{Varianca e cmimit te MD} = \text{Varianca totale} - \text{Varianca e efikasitetit (sasisë)}$

$$= (\text{€}12,000 - \text{€}11,200) - \text{€}240 \text{ PFV}$$

= €560 FAV

c. $\text{Cmimi actual i PD per oret aktuale} = ((2,000/2) \times \text{€}24) - \text{€}672 = \text{€}23,328$

Oret Aktuale = €23,328/24 = 972 ore

Kostot totale aktuale = 972 x €24.50 = €23,814

d. Varianca e cmimit per PD = €23,814 - €23,328

= €486 PFV